



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT

Të dhëna mbi Vendimin e APP Nr. 103, datë 09.10.2018

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në ushtrim të kompetencave të saj me Vendimin Nr. 103, datë 09.10.2018, APP ka vendosur të përjashtojë 3 (tre) vjet operatorin ekonomik "Alko Impex General Construction" Shpk, me NIPT K91326028I, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për paraqitje të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

I. Arsyet e heqjes së emrit të operatorit ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik:

Operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" Shpk ka kundërshtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Vendimin e APP Nr. 103, datë 09.10.2018, duke kërkuar pezullimin e këtij vendimi, deri në përfundim të gjykimit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet Vendimit Nr. 4746, datë 18.10.2018, ka pranuar kërkesën e shoqërisë "Alko Impex General Construction" Shpk, për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar efektet e aktit administrativ të APP Nr. 103, datë 09.10.2018.

Në zbatim të nenin 510, pika "a" të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: "*Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm*", emri i operatorit ekonomik "Alko Impex General Construction" Shpk është hequr nga lista e operatorëve ekonomik të përjashtuar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publik dhe në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata për këtë çështje.